



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2079 prot.

Himarë, më 28.04.2022

VENDIM

Nr. 22 datë, 28 . 04 .2022

“Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Himarë për vitin 2022”

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr. 142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” i ndryshuar, VKM nr. 165, datë 02.03.2016, i ndryshuar me VKM nr. 177, datë 08.03.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionareve të zgjedhur e të emëruar të nëpunësve civil dhe të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, VKM nr. 234, datë 20.04.2022 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, VKM nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP) të rishikuar”, VKM nr. 1149, datë 24.12.2020 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 175, datë 08.03.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar”, të ndryshuar, VKM nr. 350, datë 19.04.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, VKM nr. 158, datë 12.03.2022 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”. **Këshilli i Bashkisë Himarë në mbledhjen e radhës, datë 28.04.2022 pasi mori në shqyrtim materialin nga drejtorja përkatëse miratoi me 13 vota pro, 0 kundra, 0 abstenim dhe si më poshtë,**

VENDOSI:

1. Miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Himarë për vitin 2022, sipas lidhjeve 1,2,3,4,5,6,7 dhe 8 bashkëngjitur këtij vendimi.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i Bashkisë Himarë për vitin 2022.
3. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet *drejtoria e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse dhe drejtoria e financës, e planifikimit të buxhetit dhe e integritit evropian.*

Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i dryshuar.

KRYETARI

Dhimitër Kapaj

